



Pranuar / Doretuar Priljena / Prodato Received / Delivery	26.09.23	792	3	viti year
Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity	
SPIMSAK	6270	2023	118	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1073/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1073/2023 të datës 10.08.2023, të parashtruar nga ankuesi Flurim Kurtishaj të cilin me autorizim e përfaqëson avokat [redacted] me adresë rr. [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr.7/2023 të datës 18.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1073/2023 e datës 10.08.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

MBETET në fuqi Vendimi me Nr.7/2023 i datës 18.07.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër A.nr.672/2023 me datë 22.06.2023 me numër protokolli 4887/2023 me të cilin ka Aprovuar ankesën A.nr.672/2023 e datës 25.04.2023, e parashtruar nga ankuesi Flurim Kurtishaj dhe ka

anuluar Vendimin e Komisionit Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës me Nr.06/2023 i datës 14.04.2023 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës dhe ka Obliguar Drejtorin Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Komisionin Disiplinor që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 dite sipas pikës 1 nga dita e pranimit të tij.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.672/2023 të datës 22.06.2023, Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerr Vendim me Nr.7/2023 me datë 18.07.2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën Disiplinore Ndalim 40% të pagës për gjashtë (6) muaj.

Ankuesi Flurim Kurtishaj, i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 10.08.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5616/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.7/2023 të datës 18.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës për shkak të shkeljeve ligjore të dispozitave të Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 24.08.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 3798/2023 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Prova shtesë të datës 11.05.2023; E-mail nga T.M. për A.H.S. i datës 26.04.2023; E-mail nga T.M. për A.H.S. i datës 26.04.2023; E-mail nga A.H.S. për T.M. i datës 25.04.2023; E-mail nga F.K. për A.H.S. i datës 14.04.2023; E-mail nga F.K. për T.M. i datës 14.04.2023; E-mail nga F.K. për T.M. i datës 14.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 14.04.2023; Vendim me numër Nr.06/2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 14.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 04.04.2023; E-mail nga F.K. për T.M. i datës 04.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 03.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 03.04.2023; E-mail nga N.A. për T.M. i datës 30.03.2023; E-mail nga I.M. për N.A. i datës 30.03.2023; Akt Emërim i F.K. me numër AE. Nr. 07.2022 i datës 14.12.2022; Autorizim nga F.K. për H.S. i datës 05.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 22.05.2023; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 i datës 07.06.2023; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit me numër protokolli 1885-01 i datës 09.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Shkresë përcjellëse për KD me numër 11-04 i datës 31.03.2023; Raportet e gjeneruara nga sistemi i vijueshmërisë

në punë të ankuesit nga data 01.02.2023 deri 29.03.2023; Procesverbal i seancës të Komisionit Disiplinor i datës 12.04.2023; Urdhëresë e brendshme administrative mbi organizimin, mbikëqyrjen dhe masat për mosrespektim të orarit të punës nga stafi i Administratës Tatimore të Kosovës me numër protokollit 08-06-383 i datës 01.02.2023;

Ankesën e ankuesit me numër protokollit 5616/2023 të datës 10.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër Nr.7/2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 18.07.2023; Vendim i ATK me numër protokollit 704 i datës 18.07.2023; Procesverbal i seancës të Komisionit Disiplinor i datës 17.07.2023; Procesverbal i seancës të Komisionit Disiplinor i datës 05.07.2023; Kërkesë me numër reference 07/2023 i datës 10.07.2023; Përgjigje në kërkesë me numër reference ZDP-149/2023 i datës 11.07.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 4887/2023 i datës 22.06.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 për F.K. i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 për F.K. pa datë; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 24.08.2023; E-mail nga N.A. për T.M. i datës 30.03.2023; E-mail nga I.M. për N.A. i datës 30.03.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 04.04.2023; E-mail nga F.K. për T.M. i datës 04.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 03.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 03.04.2023; E-mail nga F.K. për T.M. i datës 04.04.2023; E-mail nga T.M. për F.K. i datës 03.04.2023; E-mail nga T.M. për H.S. i datës 14.07.2023; Raportet e gjeneruara nga sistemi i vijueshmërisë në punë të ankuesit nga data 30.01.2023 deri 29.03.2023; Urdhëresë e brendshme administrative mbi organizimin, mbikëqyrjen dhe masat për mosrespektim të orarit të punës nga stafi i Administratës Tatimore të Kosovës me numër protokollit 08-06-383 i datës 01.02.2023; Shkresë përcjellëse për KD i datës 31.03.2023; Akt Emërim i F.K. me numër AE. Nr. 07.2022 i datës 14.12.2022; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit me numër protokollit 1885-01 i datës 09.12.2022; E-mail nga T.M. për C.Z. i datës 21.09.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët nw procedurw, ka konstatuar se ankesa e ankuesi. [REDACTED] është e pabazuar, sepse:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër A.nr.672/2023 me datë 22.06.2023 me numër protokollit 4887/2023 me të cilin ka Aprovuar ankesën A.nr.672/2023 e datës 25.04.2023, e parashtruar nga ankuesi Flurim Kurtishaj dhe anulohet Vendimi i Komisionit Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës me Nr.06/2023 i datës 14.04.2023 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës dhe ka Obliguar Drejtorin Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Komisionin Disiplinor që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 dite sipas pikës 1 nga dita e pranimit të tij.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.672/2023 të datës 22.06.2023, Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore

të Kosovës ka nxjerr Vendim me Nr.7/2023 me datë 18.07.2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën Disiplinore Ndalim 40% të pagës për gjashtë (6) muaj.

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me numër AE.Nr.07/2022 të datës 14.12.2022 është i punësuar në pozitën "Drejtor i Rajonal Departamentit Tatimor" në Gjilan.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Vendimi i Komisionit Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës me Nr.7/2023 i datës 18.07.2023 është nxjerrë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Inicuesi i kërkesës për ta dërguar rastin e ankuesit në Komision Disiplinor, duke vepruar sipas kërkesës me numër reference 07/2023 të datës 10.07.2023 të Komisionit për veprime në zbatim të vendimit të KPMSHCK, me datë 11.07.2023 e ka përcjellë shkresë zyrtare të nënshkruar dhe protokolluar me numër nr.04-06-2670 me të cilën ka kërkuar që të inicohet rasti për procedurë disiplinore për zyrтарin [redacted] Drejtor i Departamentit Tatimor Rajonal në Gjilan me arsyetimin se: *Pas pranimit të e-mailit të Zëvendësues Drejtorit Ekzekutiv të ATK-së me datë 30.03.2023 si mbikëqyrës i drejtëpërdrejt i personit në fjalë njoftohem se janë pranuar informata për mos prezencë të personit në punë, dhe se bazuar në këto informata Zv. Drejtori Ekzekutiv ka kërkuar nga TI të gjeneroj raportet mbi evidentimin e vijueshmërisë së këtij zyrtari. Bazuar në këto raporte shihet se ka raste të shumta kur personi ka bërë klikim të hyrje daljeve nëpër zyra të ndryshme të ATK-së jashtë objektit të Gjilanit ku është i punësuar. Pas analizimit të këtyre raporteve të cilat janë gjeneruar me kërkesë të Zv. Drejtori Ekzekutiv, theksoj se nuk kam qenë në dijeni për mos prezencë të zyrtarit në fjalë në vendin e punës, rrjedhimisht as për klikimet nëpër zyre tjera të ATK-së, jashtë asaj të Gjilanit ku personi është i punësuar dhe përgjegjës kryesor. Këto hyrje dalje të evidentuara nëpër zyra tjera rezultojnë në mos prani të personit në punë, e rrjedhimisht në mos realizim të detyrave dhe përgjegjësi të punës dhe pamundësim në menaxhim efektiv të punës bazuar në mos prezencë. Shkeljet e konstatuar nga raportet e pranuar nga IT për klikim të hyrjes në Gjilan dhe daljes në zyre tjetër të ATK-së, apo anasjelltas, konsiderohen si shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 46 paragrafi 3, nën paragrafi 3.5, 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve tjera nënligjore. Sipas paraqitjes së klikimeve në raportet e pranuar nga TI, zyrtari në fjalë vetëm brenda muajit mars 2023 i janë evidentuar tetë (8) raste të klikimit të hyrjes në një zyrë dhe daljes në zyrën tjetër të Administratës Tatimore të Kosovës.*

Me datë 30.03.2023 Zv. Drejtori Ekzekutiv i ATK-së I.M. përmesë e-mailit zyrtar i është drejtuar Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv 1 N.A. se: *bazuar në informatat e ndryshme që kam pranuar për Drejtorin e R. Gjilanit z. F. Kurtishaj për mos prezencë të shpesht në vendin e tij të punës, unë kam kërkuar përmes personelit që nga IT-ja të nxjerret raporti mbi evidentimin e vijueshmërisë të këtij zyrtari. Nga raportet e bashkangjitura në attachment shihet se ka raste të shpeshta që Drejtori Kurtishaj ka bërë klikim të hyrje-daljeve nëpër zyre të ndryshme jashtë objektit të Gjilanit! Andaj fillimisht kërkoj nga ju të analizoni nëse këto data ka kërkuar leje nga ju për lëvizje të tilla, nëse nuk ka kërkuar leje, a jeni njoftuar se në ato data ai nuk është në vendin e tij të punës nga ora 08:16! Sipas detyrës zyrtare që*

keni në mbikëqyrje të stafit që keni nën menaxhim, kërkoj nga ju të trajtoni këtë çështje, si dhe të procedoni me masat që duhet të ndërmerri ju apo organet tjera brenda ATK-së!

Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër Nr.7/2023 të datës 18.07.2023 ndaj ankuesit të cilin mbanë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, për shkak: të shkeljeve të dispozitave ligjore sipas nenit 46, paragrafi 3, nën paragrafi 3.5, 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, të shkeljeve të dispozitave sipas nenit 9, paragrafit 1,2,3,4 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, të shkeljeve të dispozitave sipas nenit 4, paragrafit 2 të Urdhëresës së Brendshme Administrative Nr. 080-06-383 të datës 01.02.2023 mbi organizimin, mbikëqyrjen dhe masat për mosrespektim të orarit të punës nga stafi i Administratës Tatimore të Kosovës, me ç' rast Komisioni Disiplinor ankuesit në përputhje me nenin 48 paragrafi 3 në lidhje me nenin 47, paragrafin 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik i ka shqiptuar masë disiplinore ndalim 40% të pagës për gjashtë (6) muaj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi Flurim Kurtishaj duke u bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga ana e institucionit si dhe bazuar në raportet e gjeneruara nga sistemi i vijueshmërisë në punë nga data 30.01.2023 deri 29.03.2023 në Administratën Tatimore të Kosovës pa asnjë autorizim dhe pa leje paraprake ka klikuar jashtë objektit në të cilin është i sistemuar në Departamentin Tatimor në Gjilan dhe atë sipas datave si në vijim:

- Me datë 03 shkurt 2023 ka klikuar dalje në ora 16:49 në DMMB;
- Me datë 09 shkurt 2023 ka klikuar hyrje në ora 07:45 në Ferizaj;
- Me datë 10 shkurt 2023 ka klikuar hyrje në ora 07:31 në DMMB;
- Me datë 16 shkurt 2023 ka klikuar hyrje në ora 08:01 në DMMB;
- Me datë 20 shkurt 2023 ka klikuar hyrje në ora 07:22 në DMMB;
- Me datë 01 Mars 2023 ka klikuar hyrje në ora 07:31 në DMMB;
- Me datë 02 Mars 2023 ka klikuar hyrje në ora 07:55 në Ferizaj;
- Me datë 02 Mars 2023 ka klikuar dalje në ora 17:27 në DMMB;
- Me datë 03 Mars 2023 ka klikuar dalje në ora 16:19 në DMMB;
- Me datë 07 Mars 2023 ka klikuar dalje në ora 16:40 në Prizren;
- Me datë 08 Mars 2023 ka klikuar dalje në ora 16:26 në DMMB;
- Me datë 15 Mars 2023 ka klikuar dalje në ora 15:40 në Ferizaj;
- Me datë 28 Mars 2023 ka klikuar dalje në ora 16:44 në Arkat Fiskale;
- Me datë 29 Mars 2023 ka klikuar hyrje në ora 08:00 në DMMB;

Kolegji i Këshillit po ashtu ka konstatuar se bazuar në Urdhëresën e Brendshme Administrative Mbi Organizimin, Mbikëqyrjen dhe Masat për Mosrespektim të Orarit të Punës nga stafi i Administratës Tatimore të Kosovës me numër protokollit 08-06-383 të datës 01.02.2023, ankuesi ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 2 i cili përcakton se: *Të gjithë zyrtarët e Administratës Tatimore pa përjashtim janë të obliguar që të regjistrohen në*

sistemin elektronik të vijueshmërisë si dhe të jenë prezent në vendin e punës. Mos regjistrimi në sistem konsiderohet mos prezencë në punë.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik konkretisht me nenin 9 paragrafin 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 ku përcaktohet se: 1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mosregjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mosprezencë në punë. 4. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore. 6. Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, konkretisht Kolegji analizoj: Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: "shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë" ndërsa "Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".

Nenin 47 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë

deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: *“1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”.*

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh të gjitha këto prova të lëndës, konstaton se ankuesi me veprimet e tij, ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5, 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse me veprimet e tij ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2, 3 nenin 27 paragrafi 3 dhe nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *Neni 25 Detyrimi i respektimit të ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut, 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përfundimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike. Neni 27 Detyrimi i administrimit të mirë të pasurisë shtetërore, 3. Zyrtari publik është i detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij të punës, dhe Neni 28 Detyrimi i përgjegjshmërisë, Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij. Si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5, 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.*

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.7/2023 të datës 18.07.2023, ka vepruar në pajtim me nenin 45, 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 nenin 48 paragrafi 3, të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat të nenit 11, 12, 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa arsyetimi i vendimit është në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë Kolegji, konstaton se pretendimet e ankuesit ndaj kësaj mase janë të pabazuara.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1073/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës


Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit [REDACTED]
- Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës ;
- Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;